



AKADEMIA E SHKENCAVE
DHE E ARTEVE E KOSOVËS
SEKSIONI I ARTEVE

MBRËMJE MUZIKORE-LETRARE

PËR NDER TË 7-VJETORIT TË
PAVARËSISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

INTERPRETOJNË:

SELMAN LOKAJ
AKTOR

MARIGONA ÇERKEZI
SOPRANO

MISBAH KAÇAMAKU
PIANO

E HËNË
16 SHKURT
ORA 18:00
SALLA E
AKADEMISË

MBRËMJE MUZIKORE-LETRARE

FJALA E RASTIT: AKADEMIK HIVZI ISLAMI, KRYETAR

ZEQIRJA BALLATA

MES RRUGËS RRUGA (I.KADRIU), PËR ZË E PIANO

RAUF DHOMI

PA LAMTUMIRË (A. DHOMI), PËR ZË E PIANO

MENDI MENGJIQI

KËNGA E KURBETIT (PËRP.), PËR ZË E PIANO

W. A. MOZART

ARIA "PORGI AMOR" NGA OPERA "LE NOZZE DI FIGARO"

MARIGONA ÇERKEZI, SOPRANO

MISBAH KAÇAMAKU, PIANO

KADARE/SHKRELI/PASHKU/

PODRIMJA/DERVISHI/KAJTAZI

MALL LIRIE

SELMAN LOKAJ, AKTOR

RAUF DHOMI

KOPSHTI I DASHURISË, PËR ZË E PIANO

ZEQIRJA BALLATA

AS AMAN O SYR I ZI (PËRP.), PËR ZË E PIANO

AVNI MULA

AGIMET SHQIPTARE

W. A. MOZART

ARIA "E SUSANNA NON VIEN...DOVE SONO" NGA OPERA "LE NOZZE DI FIGARO"

MARIGONA ÇERKEZI, SOPRANO

MISBAH KAÇAMAKU, PIANO

MBRËMJA E SOTME MUZIKORE-LETRARE ËSHTË SAJUAR NË MËNYRË PAKSA MË TË VEÇANTË. KJO ËSHTË E NATYRSHME, SEPSE I KUSHTOHET PËRVJETORIT TË 7-TË TË PAVARËSISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, ME DËSHIRAT PËR PROSPERITET, PËR NJË TË ARDHME MË TË MIRË.

JANË PËRZGJEDHUR GJITHSEJ GJASHTË ROMANCA, PËRKATËSISHT KËNGË SOLO ME SHOQËRIM TË PIANOS, TË KOMPOZITORËVE TANË TË NJOHUR BREZASH TË NDRYSHËM, DY DUETE VOKALE OPERISTIKE TË NJË KOMPOZITORI GJENIAL KLASIK, SI DHE NJË CIKËL FRAGMENTESH POETIKE-LETRARE TË GJASHTË KRIJUESVE TANË TË MIRËNJOHUR.

FILLIMISHT RADHITEN KATËR ROMANCA PËR ZË E PIANO TË AUTORËVE TANË, TË TË CILAT - NË NJË MËNYRË A TJETËR - PËRÇOHET ÇËSHTJA E LIRISË, MËVETËSISË (Z. BALLATA, MES RRUGËS RRUGA, VARGJET I. KADRIU, KUSHTUAR LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT) DHE E TË RËNËVE (R. DHOMI, PA LAMTUMIRË, VARGJET A. DHOMI, KUSHTUAR USHTARIT TË RËNË), SI DHE E PLAGËS SË KAMOTSHME - KURBETIT (M. MENGJIQI, KËNGA E KURBETIT, E PËRPUNUAR). TË TRIA KËTYRE ROMANCAVE I BASHKËNGJITET DHE ARIA OPERISTIKE E KOMPOZITORIT KLASIK (W. A. MOZART).VIJOHET, MË PAS, ME FRAGMENTET POETIKE-LETRARE TË SHKRIRA NË NJË TËRËSI ME TITULL MALL LIRIE TË GJASHTË KRIJUESVE TANË GJITHANDEJ TË MIRËNJOHUR (I. KADARE, A. SHKRELI, A. PASHKU, A. PODRIMJA, T. DERVISHI, M. KAJTAZI), FRAGMENTE QË, GJITHASHTU, ME VARGJE POETIKE DHE NË PROZË, E PLOTËSOJNË, PO KËSHTU, TË NJËJTËN FRYMË. MBRËMJA SOLEMNE VAZHDOHET SËRISH ME TRI ROMANCA TË TJERA, PO TË KOMPOZITORËVE TANË: R. DHOMI, KOPSHTI I DASHURISË (VARGJET A. Z. ÇAJUPI); Z. BALLATA, AS AMAN O SYR I ZI (E PËRPUNUAR); A. MULA, AGIME SHQIPTARE (VARGJET AUTORI), PORSE TANI, JO PA QËLLIM, ME NJË TON PAKSA MË LIRIK E OPTIMIST, ASHTU SIÇ ISHTE DHE VAZHDON TË JETË EDHE MË TEJ (!) POPULLI YNË ME SYNIMET MË SUBLIME PËR NJË TË ARDHME MË NJERËZORE DHE MË TË PËRBASHKUAR KOMBËTARE. PROGRAMI ARTISTIK KUSHTUAR 7-VJETORIT TË PAVARËSISË SË VENDIT TONË PËRMBYLLET ARIEN TJETËR TË SË NJËJTËS OPERË TË GJENIUT MOZART.

AKTORI SELMAN LOKAJ, ËSHTË DOAJEN I AKTORËVE TANË, ME HABITUS FIZIK E LËVIZJE, ME HIR SKENIK NË DËRRASAT TEATRORE, DRAMATIK E IMPOZANT, ME ZË TË NGROHTË E DREJTPESHIM NË FJALË E GJESTE, ME ENERGJI TË BRENDSHME, DIAPAZON INTONATIV E DIKSION PREJ BARITONI NË VEPRAT ARTISTIKE VENDORE E BOTËRORE, NË TEATËR, FILM E TELEVIZION, NË KOSOVË, SHQIPËRI, SLOVENI, FRANCË... SONTE DO T'I INTERPRETOJË SKENISHT PROZAT/POEZITË E SHKRIMTARËVE/POETËVE TANË TË MIRËNJOHUR: I. KADARE, A. SHKRELI, A. PASHKU, A. PODRIMJA, T. DERVISHI, M. KAJTAZI.

SOPRANOJA E RE E TALENTUAR MARIGONA ÇERKEZI I ËSHTË QASUR HERËT PARALELISHT MËSIMIT, MË PAS STUDIMEVE TË SOLOKËNDIMIT DHE TË FLAUTIT (U DIPLOMUA TE E ËMA, MEXOSOPRANOJA MERITA JUNIKU; TE FLAUTISTJA VENERA MEHMETAGAJ KAJTAZI). PO KËSHTU QË HERËT EDHE ME PJESËMARRJE NË FESTIVALE NË KOSOVË E SHQIPËRI, NË ISH-JUGOSLLAVI DHE MË GJERË (RUSI, ITALI, SHBA) SI KËNGËTARE A FLAUTISTE, DUKE U SHPËRBLIYER EDHE NË KONKURSET NDËRKOMBËTARE "MARIE KRAJA" (SHQIPËRI) DHE NË ATË "ASLIKO" (ITALI).

PIANISTI YNË MISBAH KAÇAMAKU, PAS SHKOLLIMIT FILLOR E TË MESËM, STUDIOI NË KONSERVATORIN PEDAGOGJIK "GNJESINIH" NË MOSKË, DUKE U DIPLOMUA MË PAS NË DREJTIMIN E PIANOS NË FAKULTETIT E ARTEVE NË PRISHTINË. NË VIJIM I KA KRYER DHE STUDIMET PASDIPLOMIKE NË FAKULTETIN MUZIKOR TË SHKUPIT. SI PIANIST ËSHTË AKTIV DHE I SUKSESSHËM, QOFTË SI SOLIST, QOFTË SI ANËTAR ANSAMBLESH KAMERALE NË KOSOVË, POR EDHE JASHTË SAJ NË MAQËDONI, SLOVENI, ZVICËR, SPANJË, GJERMANI... TANI I VIJON STUDIMET E DOKTORATËS NË SHKUP. NJËHERËSH ËSHTË PROF. ASISTENT NË FAKULTETIN E ARTEVE NË PRISHTINË.